

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për shtetësinë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Brendshme
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Fazë konsultimi publik dhe bashkërendimi ndërinstitucional
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Konventa Europiane “Për shtetësinë”, ratifikuar me ligjin nr. 8942, datë 19.9.2002 “Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për shtetësinë”; Konventa “Për reduktimin e pashtetësisë”, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9059, datë 8.05.2003;
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	10.12.2018
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	28 gusht 2018 dhe 2.11.2018
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2018 – MB–01
TË DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Renata BALLIU; Renata.balliu@mb.gov.al 0694118450 Donjet GJOKA; Donjet.gjoka@mb.gov.al ; 0699187704 Valbona GJIKA; Valbona.gjika@mg.gov.al ; 0694109070.
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	
Kuadri ligjor që rregullon çështjet për shtetësinë shqiptare përbëhet nga ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, i ndryshuar; Vendimi nr. 554, datë 3.07.2013 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës”, udhëzimit të përbashkët 925, datë 3.03.1999 të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Ministrit të Punëve të Jashtme “Për procedurat që ndiqen për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim”, i ndryshuar.	

Ky kuadër ligjor paraqitet shumë i hershëm dhe nuk i përgjigjet disa problematikave të konstatuara në praktikë, që kryesisht janë:

- Mos regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile 2010 të personave të cilët kanë fituar shtetësinë shqiptare (me dekret presidencial), por që mosparaqitja brenda një afati të caktuar nga zyrat e gjendjes civile ka çuar, në vijim në një refuzim nga ana e këtyre zyrave të regjistrimit të tyre. Si rrjedhojë, këta persona nuk mund të gëzojnë të drejtat që lidhen me të pasurit shtetësinë shqiptare (e drejta e votës, e punësimit në institucionet shtetërore, pajisja me pasaporte apo letërnjoftim elektronik). Pra, shtetësia shqiptare nuk është bërë efektive për këtë kategori.
- Zbatimi i kriterëve të fitimit të shtetësisë me natyralizim edhe për personat të cilët kërkojnë të rimarrin shtetësinë shqiptare. Për këtë kategori subjektesh duhet të përcaktohen kriterë më “lehtësues”, pasi këta persona kanë patur shtetësinë shqiptare;
- Mos regjistrimi (në RKGJC 2010) i fëmijëve që lindin në një shtet të huaj, duke patur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare. E drejta për t’u regjistruar në zyrat e gjendjes civile nuk parashkruhet edhe nëse personi ka mbushur 18 vjeç;
- Zgjidhje e problematikës së krijuar në praktikë për paraqitjen e kërkesës për heqje dorë nga shtetësia shqiptare në rast të prindërve të divorcuar. Aktualisht legjislacioni parashikon që kërkesa duhet të paraqitet nga të dy prindërit, kjo ka krijuar problem në rast të mos dakordësisë (kur kujdestar ligjor është vetëm njëri prind) dhe/ose mosgjetyes së njërit prind. Kështu, është parashikuar që nëse prindërit janë të divorcuar, kërkesa për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, bëhet nga prindi, të cilit i është lënë përgjegjësia prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë.

Përpos problematikave si më sipër, të cilat janë konstatuar nga zbatimi në praktikë i ligjit, ndërhyrja e qeverisë është vlerësuar e nevojshme për sa më poshtë:

- Rregullimi në ligjin organik, i çështjes së dhënies së shtetësisë shqiptare të të huajve që kryejnë një investim në sektorë strategjikë me interes publik. Është parë e nevojshme që këtij kriteri për fitimin e shtetësisë, t’i shtohen edhe filtra të tjerë kontrolli me qëllim shmangien e abuzimeve. Kështu, është menduar që mund të aplikojnë për fitimin e shtetësisë të huajt që kryejnë investime në sektorë strategjikë në RSH, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin për të huajt dhe që kanë banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 3 vjet në territorin e RSH-së;
- Rregullimi i çështjes së personave me status refugjati apo me mbrojtje plotësuese, të cilët edhe pse qëndrojnë për një kohë të gjatë në territorin e RSH, deri më tani nuk i është njohur e drejta e fitimit të shtetësisë shqiptare;
- Përcaktimi i afateve realisht të respektueshëm dhe zbatueshëm nga strukturat

përgjegjëse për ndjekjen e procedurave, si dhe lehtësimi i procedurave të fitimit të shtetësisë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të kësaj politike janë:

- Reduktimi i pashtetësisë;
- Zhvillimi i ekonomisë dhe ulja e papunësisë. Dhënia e shtetësisë shqiptare të huajve për investime strategjike, do të ndikojë në mënyrë indirekte në zhvillimin e ekonomisë dhe reduktimin e papunësisë. Rregullimi dhe përcaktimi i kriterëve të veçantë/kufizues për fitimin e shtetësisë për investime strategjike krijon filtrat e duhur për dhënien e shtetësisë shqiptare personave të cilët realisht kryejnë investime që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë së vendit.
- Rritja e numrit të popullsisë: Mos parashkrimi i së drejtës së regjistrimit në RKGJC 2010, për personat të cilët kanë lindur nga prindër shqiptarë, por jashtë territorit të RSH-së, si dhe fitimi i shtetësisë shqiptare nëpërmjet origjinës, do të ndikojë në rritjen e numrit të popullsisë shqiptare;
- Fuqizimi i kushtit të njohjes së gjuhës shqipe, si dhe i njohurive bazë të historisë dhe Kushtetutës së RSH, kriterë të cilët janë kumulativë për fitimin e shtetësisë;
- Njohja e të drejtave kushtetuese që lidhen me të pasurit shtetësinë shqiptare, refugjatëve apo personat me mbrojtje plotësuese: fitimi i shtetësisë shqiptare për këto kategori personash, duke përcaktuar si kusht, qëndrimin në mënyrë të ligjshme dhe banimin në Republikën e Shqipërisë për një periudhë të vazhdueshme prej jo më pak se 10 vjet nga dita e komunikimit të statusit, do të ndikojë në integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 – status *quo*-ja.

Opsioni 1 - miratimi i një ligji të ri organik “Për shtetësinë”.

Opsioni 2 – ndryshimi i ligjit ekzistues, nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, i ndryshuar, si dhe i akteve nënligjore përkatëse.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar, pritet të shoqërohet **me ndikime sociale në dy aspekte**: regjistrimi i personave të cilët kanë fituar shtetësinë shqiptare me dekret presidencial, por që nuk janë regjistruar në zyrat e gjendjes civile përkatëse, si dhe regjistrimi i personave që kanë mbushur moshën 18 vjeç, të lindur jashtë territorit shqiptar qoftë edhe me njërin prind më shtetësi shqiptare, do të sjellë rritje të numrit të popullsisë shqiptare, si dhe ushtrimin nga ana e kësaj kategorie subjektesh, **të të drejtave që lidhen me të pasurit shtetësinë shqiptare.**

Në mënyrë indirekte, kjo do të shoqërohet **me ndikime ekonomike pozitive**, pasi kjo kategori personash që nëpërmjet regjistrimit në zyrat e gjendjes civile, u bëhet efektive shtetësia shqiptare (ushtrim të të drejtave sociale dhe përfitime fiskale), mund të investojë të ardhurat në territorin shqiptar.

Dhënia e shtetësisë shqiptare të huajve, nëse Republika e Shqipërisë ka një interes shkencor, kulturor apo kombëtar, shoqërohet me **efekte ekonomike apo sociale pozitive**, pasi motivon ushtrimin e veprimtarive me interes për Shqipërinë.

Fitimi i shtetësisë shqiptare për të huajt që kryejnë një investim në sektorë strategjikë me interes publik sipas legjislacionit përkatës në fuqi (ligji për investimet strategjike), në respektim të kushteve të përcaktuara në ligjin për të huajt dhe që kanë banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 3 vjet në territorin e RSH-së, shoqërohet me **efekte ekonomike pozitive, në mënyrë direkte**: rritje e të ardhurave për buxhetin e shtetit; rritje të numrit të të punësuarve, si dhe indirekte, zhvillim ekonomik të vendit.

Gjithashtu, efekte financiare pozitive, në mënyrë direkte, sjell rritja e tarifës për shërbimin (aplikim për fitimin/lënien e shtetësisë). Tarifa aktuale nuk korrespondon me koston e shërbimit dhe përshtatja e saj do të sillte rritje të të ardhurave në buxhetin e shtetit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është Opsioni 1, pasi përpos problematikave si më sipërcaktuar, nevoja e miratimit të një ligji të ri diktohet edhe nga domosdoshmëria e harmonizimit të legjislacionit për shtetësinë me kuadrin ligjor ekzistues që rregullon çështjet e lidhura me këtë fushë, i cili jo vetëm që daton pas miratimit të këtij ligji, por edhe ka qenë subjekt i ndryshimeve që duhet të reflektohen në projektligjin e ri. Mund të përmendim:

- ligjin nr. 134/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar;
- ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, të ndryshuar;
- ligjin nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;
- ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

- ligjin nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas të dhënave të Sektorit të Shtetësisë për vitin 2018, parashikohet të aplikojnë për shtetësinë shqiptare rreth 1 000 persona, nga të cilat 700 persona kanë aplikuar brenda vendit dhe 300 persona jashtë vendit, ku janë rezidentë. Aktualisht mbështetur në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Punëve të Jashtme nr.6252, datë 10.12.2001 dhe të Ministrisë së Rendit Publik nr. 3583, datë 27.11.2001 “Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare”, tarifa e shërbimit (aplikimi për shtetësi) është në masën 5 000 lekë për personat që aplikojnë brenda vendit, dhe 30 euro për personat që aplikojnë pranë përfaqësive diplomatike. Për vitin 2018 të ardhurat për Buxhetin e Shtetit parashikohen të jenë në vlerën 4 760 mijë lekë. Këto të ardhurat derdhen në Buxhetin e Shtetit, pra nuk përdoren nga strukturat/njësitë që i krijojnë ato.

Parashikohet që numri i aplikantëve sipas këtij projektligji të jetë rreth 1 500 persona. Tarifa për aplikim propozohet të jetë në vlerën 300 euro, referuar edhe tarifave që zbatohen në nivel rajonal, si dhe do të miratohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme. Të ardhurat që parashikon për Buxhetin e Shtetit, nëse kjo tarifë miratohet janë në vlerën 63 milion lekë.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

Ky projektligji nuk parashikohet të ketë kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit, pasi do zbatohet nga strukturat aktuale përkatëse. Megjithatë parashikohet rritje e numrit të aplikantëve, ndryshimi i afateve procedurale (duke i zgjatur nga 6 në 9 muaj) bën të përballueshëm fluksin e aplikimeve nga strukturat përkatëse. Pra nuk paraqiten kosto administrative shtesë.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji gjatë fazës së hartimit të tij është konsultuar gjerësisht me përfaqësues të UNHCR-së, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në lidhje me përmbajtjen e projektaktit. Gjithashtu, gjatë procedurës së bashkërendimit ndërinstitutional, projektligji do të publikohet në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Në implementimin efektiv të këtij projektligji do të ndikojë zbatimi i dispozitave tranzitore, si dhe zbatimi disa akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me përcaktimet e këtij ligji si:

ligji për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë /ligji për të huajt; standardet e miratuara të banimit, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave që përcakton burimet e mjaftueshme financiare për jetesën. Gjithashtu, në implementimin e këtij projektligji do të ndikojë edhe miratimi i disa akteve nënligjore, në zbatim të tij, si:

- Miratimi i VKM- së për rregullat e dhënies së shtetësisë shqiptare nëse Republika e Shqipërisë ka një interes shkencor, kulturor dhe kombëtar);
- Udhëzim i Ministrit të Brendshëm, për procedurën që duhet të ndiqet;
- Udhëzim i Ministrit përgjegjës për Arsimin, për verifikimin e njohurive të gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, të certifikuar nga institucioni përkatës arsimor publik, si dhe i njohurive bazë të historisë dhe të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, si dhe Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, për përcaktimin e tarifës së aplikimit.

Përveç mekanizmave ligjorë si më sipërcaktuar, edhe mekanizmat institucionalë, si: Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, strukturat vendore të policisë apo postet konsullore ku paraqitet aplikimi i personave të interesuar do të shërbejnë si mekanizma zbatues dhe monitorues.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji “Për shtetësinë shqiptare” daton në vitin 1998 dhe është ndryshuar vetëm një herë në vitin 1999, ku është shtuar fitimi i shtetësisë shqiptare për të lindurit qoftë edhe nga njëri prind me shtetësi shqiptare, si edhe humbja e shtetësisë shqiptare për të miturit, në rast kur njëri prind ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare edhe është dhënë pëlqimi i të dy prindërve. Vendimi për të miratuar një projektligj të ri erdhi si rezultat i nevojës së zgjidhjeve të disa problematikave të hasura në praktikë, si dhe përqafimit të një qasje disi më zgjeruese të kriterëve për disa kategori subjektesh, dhe më “kufizuese”, për kriterë të tjera (fitimi i shtetësisë për investime strategjike) të fitimit të shtetësisë shqiptare.

Projektligji nuk parashikon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian. Gjithsesi hartimi i tij është në përputhje me Konventën Europiane “Për shtetësinë”, ratifikuar me ligjin nr. 8942, datë 19.9.2002 “Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për shtetësinë”, si dhe Konventën “Për reduktimin e pashtetësisë”, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9059, datë 8.05.2003. Gjithashtu, në hartimin e këtij projektligji

grupi i punës ka kryer hulumtime të sistemeve fqinje dhe janë marrë në konsideratë ato sisteme që më shumë i përshtaten kontekstit shqiptar.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problematikat e konstatuara mund të ndahen në 2 kategori:

1. Problematika që lidhen me zbatimin në praktikë të ligjit aktual, në veçanti mos regjistrimi në RKGJC, të vitit 2010 të personave që kanë fituar shtetësinë shqiptare, por që për arsye objektive apo për shkaqe të ndryshme nuk janë paraqitur për regjistrim pranë zyrave të gjendjes civile, si dhe pamundësia e përfundimit të procedurave brenda afateve të përcaktuara;
2. Problematika të natyrës ligjore, si: nevoja për ndërhyrje ligjore për çështjet, si: dhënia e shtetësisë shqiptare personave me status refugjati apo me mbrojtje plotësuese, rregullimi në ligj organik i çështjes së dhënies së shtetësisë për investime strategjike; njohja e shtetësisë shqiptare me origjinë (aktualisht rregulluar me akt nënligjor).

Shkaqet e problematikave si më sipër përshkruar, lidhen ngushtësisht me faktin se kuadri ligjor paraqitet shumë i hershëm dhe jo i harmonizuar me legjislacionin në fuqi që prek çështjet e shtetësisë shqiptare;

Grupet e prekura nga problematikat e analizuara mund të ndahen në disa kategori:

- Personat pa shtetësi, të lindur nga prindër shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Personat që kanë marrë statusin e refugjatit apo mbrojtje plotësuese;
- Të huajt që kanë interes për të kryer investime në sektorë strategjikë me interes publik;
- Persona që kanë origjinë shqiptare, pra janë pjesë e diasporës shqiptare;

Nga analiza që është bërë kuadrit ligjor ekzistues është vlerësuar e nevojshme ndërhyrja e politikës me qëllim dhënien e zgjidhjeve të qëndrueshme në këtë kuadër.

Arsyeja e ndërhyrjes

Në kuadër të procesit të analizimit të problematikave dhe vlerësimit të zgjidhjeve të mundshme, është analizuar kuadri ligjor ndërkombëtar i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë dhe kuadri ligjor në fuqi, si dhe ai i miratuar që nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 8389/1998. Gjithashtu, u analizuan problematikat e ndeshura në praktikë, gjatë zbatimit të këtij ligji dhe pas vlerësimit të ndryshimeve që duhet të bëheshin në ligjin nr.8389/1998, u

arrit në konkluzionin që nevojitet ndërhyrja e politikës me qëllim propozimin e nismës ligjore që do të sjellë ndryshimin e gjithë kuadrit ligjor të shtetësisë.

Objektivi i politikës

- Zgjerimi i mënyrave të fitimit të shtetësisë, pasi është parashikuar fitimi i shtetësisë me origjinë, duke i dhënë kështu mundësinë dhe asaj pjese të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, si pjesës që ka emigruar në mënyrë të hershme, por dhe pjesës që ka emigruar pas ndryshimeve që ndodhën në vendin tonë, pas viteve '90, dhe që dëshirojnë të kenë një lidhje të qëndrueshme juridike me shtetin shqiptar;
- Krite më të qarta, për fitimin e shtetësisë shqiptare, të cilat ndryshojnë në varësi të mënyrës së fitimit dhe të kategorisë së të huajve, duke përcaktuar krite të ndryshme p.sh. për të huajt që kryejnë investime strategjike në sektor publik;
- Krite më të lehtësuara, për personat që kanë patur më përpara shtetësinë shqiptare;
- Forcimi i kriterëve për dhënien e shtetësisë me natyralizim, kur Republika e Shqipërisë ka një interes ekonomik, të paraqitur në formën e një investimi;
- Dhënia e shtetësisë shqiptare refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese, duke përcaktuar edhe kushtet që duhet të plotësohen, për këtë qëllim.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

OPSIONI 0 (status quo-ja)

Nëse nuk ndërhyhet nëpërmjet ndryshimit të kuadrit ligjor ekzistues, nuk mund të zgjidhen problematikat të lidhura me afatet procedurale, me nevojën e zgjerimit të kriterëve të fitimit, si dhe problematika të tjera të hasura nga zbatimi në praktikë i ligjit aktual. Gjithashtu, nuk do jetë e mundur të harmonizohet kuadri ligjor që rregullon shtetësinë shqiptare me legjislacionin në fuqi që prek çështjet e shtetësisë.

Opsioni 1 (i preferuar) Miratimi i një ligji të ri:

Miratimi i një projektligji të ri do të sillte një model të ri të kriterëve, mënyrave të fitimit dhe rifitimit të shtetësisë shqiptare, si dhe procedurave që ndiqen për çdo rast. Gjithashtu, ligji i ri do të mundësonte rregullimin e disa çështjeve nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore përkatëse, si dhe zgjeron kriteret e fitimit të shtetësisë (parashikim që mund të bëhet vetëm nëpërmjet nismës legjislative), duke i dhënë zgjidhje kështu problematikave të paraqitura në veçanti, por jo vetëm, nga personat me origjinë shqiptare ose të lindur nga prindër shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Opsioni 2, ndryshimi i ligjit ekzistues dhe i akteve nënligjore përkatëse.

Ky opsion do të sillte ndryshimin e pjesës më të madhe të dispozitave të projektligjit dhe referuar rregullave të teknikës legjislative, kjo do të krijonte paqartësi apo vështirësi në interpretimin dhe zbatimin e aktit.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

1. Për efekt të këtij vlerësimi të ndikimit dhe në mungesë të ndërhyrjes, do të ketë më shumë persona të cilëve do t'ju mohohet e drejta për t'u regjistruar në zyrat e gjendjes civile, pavarësisht se me dekret presidencial kanë fituar shtetësinë shqiptare. Gjithashtu, edhe personat që janë pjesë e diasporës shqiptare, nuk do të kenë garancinë ligjore për të fituar shtetësinë shqiptare. Po ashtu, mosndërhyrja për të rregulluar çështjen e dhënies së shtetësisë shqiptare, duke kufizuar kushtet/kriteret e fitimit do të sillte një mungesë sigurie dhe garancie në zhvillimin ekonomik të vendit nëpërmjet këtyre investimeve (në veçanti, mungesa e kontrollit nga strukturat përgjegjëse në këtë sektorë kaq të rëndësishëm.

Mosndërhyrja e politikës do të shoqërohej me ndikime sociale negative, në veçanti për shqiptarët e lindur jashtë territorit të RSH-së, të cilëve i'u është mohuar ushtrimi i disa të drejtave që lidhen me shtetësinë shqiptare. Po kështu, edhe mungesa e garancisë ligjore për t'ju njohur shtetësia shqiptare paraardhësve të cilët duan të mbajnë lidhje me shtetin e origjinës. Ndikimet sociale, në mënyrë indirekte shoqërohen me efekte ekonomike negative.

2. Propozimi i politikës, nëpërmjet këtij projektligji do të shoqërohet me ndikime sociale dhe ekonomike pozitive. Rritje të numrit të popullsisë, integrimi i personave me status refugjati apo mbrojtje plotësuese; zhvillim ekonomik të vendit duke kufizuar dhënien e shtetësisë për investime strategjike vetëm atyre subjekteve që realisht dhe objektivisht plotësojnë kriteret, si dhe punësojnë një numër të caktuar shtetasish shqiptarë.

Ndikime ekonomike pozitive, në mënyrë të drejtpërdrejtë do të sjellë rritja e tarifës për aplikim pranë strukturave vendore të policisë apo posteve konsullore të shërbimit, duke e përshtatur me koston e shërbimit, në veçanti kur ky aplikim bëhet pranë këtyre të fundit.

3. Sa i takon ndikimeve që mund të sillte opsioni 2 (ndryshimi i ligjit ekzistues), mund të themi se duke qenë se ndryshimet do të ishin më të pakta në krahasim me propozimin e një ligji të ri, do të konstatoheshin më pak përmirësime në drejtim të problematikave të konstatuara në praktikë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është hartimi dhe miratimi i një ligji të ri të harmonizuar me legjislacionin që prek çështjet e shtetësisë, pasi bazuar në analizën e dispozitave që do të prekeshin nga ndryshimet u arrit në përfundimin se nuk mund të procedohej me ndryshimin e ligjit ekzistues. Në fakt, me reflektimin e ndryshimeve në ligjin ekzistues, rezultonte se ato përbënin më shumë se 50 % të dispozitave, kështu që duhej patjetër të ndërmerrej nisma për një ligj të ri.

Gjithashtu, nevoja e parashikimit të dispozitës tranzitore për kërkesat për fitimin, rifitimin apo lënien e shtetësisë shqiptare, si dhe për personat që kanë lënë shtetësinë shqiptare, por që para hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë fituar shtetësi tjetër, diktonte domosdoshmërinë e miratimit të një ligji të ri.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Strukturat vendore të policisë, postet konsullore dhe drejtoria për azilin dhe shtetësinë, pranë Ministrisë së Brendshme, do të jenë strukturat kryesore të ngarkuara më përgjegjësinë e zbatimit të këtij projektligji. Nuk parashikohen pengesa të mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur, pasi strukturat përgjegjëse do të bazohen në kriteret dhe procedurën e përcaktuar qartazi në ligj dhe akte nënligjore. Sa i takon masave për të arritur qëllimin e politikës dhe kërkesat e zbatimit, e rëndësishme është nevoja e miratimit të akteve nënligjore që do të bëjnë të zbatueshëm ligjin, si dhe zbatimi korrekt i kërkesave ligjore, në veçanti nga strukturat vendore të policisë së shtetit.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblodhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Strukturat vendore të policisë, postet konsullore, si dhe sektori i shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme, si struktura që ngarkohen drejtpërdrejtë me zbatimin e këtij projektligji, do të vlerësojnë dhe efektivitetin e tij. Si tregues për matjen e arritjes së qëllimit, mund të përmendim, përfundimin e procedurës brenda afateve, reduktimin e numrit të ankesave, regjistrimin në RKGJC të personave shqiptarë të lindur jashtë territorit të RSH, rritja e numrit të aplikimeve etj.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim	58 mil									
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total	58 mil									
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total	58 mil.									
Vlera aktuale e përfitimit në total										

Vlera aktuale neto (VAN) =Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	
--	--

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1		58 mil.	58 mil.
Opsioni 2			

